



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 375 Prot

Tiranë, më 24, 12, 2014

VENDIM Nr. 368 datë 12.12.2014

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 12.12.2014, pasi shqyrtoi "Relacionin e Vëzhgimit Arkeologjik" për projektin "BYPASS-Vlorë", Autoriteti Rrugor Shqiptar", realizuar nga ASHA dhe DRKK Vlorë,

VENDOSI:

- I. Në vazhdim të "Relacionit të Vëzhgimit Arkeologjik për projektin "BYPASS-Vlorë", Autoriteti Rrugor Shqiptar", që ka evidentuar paraprakisht zonat me potencial arkeologjik, përkatësisht zona pranë fshatit Tragjas i Ri nga KM:25+000 deri në KM:26+500 dhe zona nga KM:10+420 ( në hyrje të fshatit Kaninë) deri në KM:12+100 (në dalje të fshatit Kaninë), ku gjurma e rrugës kalon rreth 400m nga kalaja e Kaninës dhe 350m nga varreza antike, *të plotësohet VNM me komponentin e trashëgimisë kulturore duke kryer dhe vëzhgimin arkeologjik intensiv.*
- II. Rezultatet e VNM -së, të plotësuar me komponentin e Trashëgimisë Kulturore dhe "Raporti i Vëzhgimit Arkeologjik" intensiv në funksion të tij, të paraqiten në mbledhjen e ardhshme të KKA.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO